



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “THOMA PAPAPANO” GJIROKASTËR

Nr. 94 Prot.

Gjirokastër, më: 29/03/ 2023

Lënda : Njoftim për vend të lire:

Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore , përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional “,

Shkolla e mesme profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastër ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin mësimdhënës me **kohë të pjesëshme** të “Teorisë Profesionale”:

- Mësimdhënës i lëndës “Teori Profesionale ” në drejtimin mësimor “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kriteret:

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;



- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjten fushë me kualifikimin profesional të kërkuar.
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;
- Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021).
- Kartën e identitetit;
- Diplomën;
- Librezën e punës;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;
- Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
- Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.
- Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e SHMP "Thoma Papapano" Gjirokastër së brenda datës 7.4.2023.



Drejtori

Renata Puleri